



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

Nr. _____ Prot.

Kukës me, _____.____.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____.____.2025

PËR

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDORUESVE FAKTIKË TË TOKËS BUJQËSORE NË BAZE TË LIGJIT NR. 20/2020, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCESHEVE KALIMTARE TË PRONËSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NË FSHATIN GOSTIL“

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (*i ndryshuar*), nenet 8/2, 9/1/1.2, 24/2, 54/e, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në RSH, ”, Ligjit Nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-se Nr.1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësisë të tokës bujqësore”, te:

MIRATOJË:

1. Listen e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, sipas nenit 14, të Ligjit Nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI
Albert HALILAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

PËR

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDORUESVE FAKTIKË TË TOKËS BUJQËSORE NË BAZE TË LIGJIT NR. 20/2020, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCESVE KALIMTARE TË PRONËSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NË FSHATIN GOSTIL“

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), nenet 8/2, 9/1/1.2, 24/2, 54/e, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në RSH”, Ligjit Nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-se Nr.1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësisë të tokës bujqësore”, bashkangjitur ju paraqesim për miratim P/Vendimin për:

Miratimin e Listes së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, sipas nenit 14, të Ligjit Nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”,

Në vijim të procedurave të parashikuar në ligjin Nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Seksioni 3, Neni 12, Kushtet për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, përfitojnë kalim në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore subjektet, që sipas pikës C, kanë paraqitur kërkesë deri në 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për plotësimin me AMTP për tokat e ish kooperativave bujqësore apo ish ndërmarrjeve bujqësore.

Drejtoria Vendore e Kadastrës Kukës ka kryer procedurat për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe dosjeve të kërkesave të qytetarëve në fshatin Gostil, zona kadastrale 1819.

Gjate muajve Shkurt-Mars 2025 është përpiluar lista e përdoruesve faktik për 36 subjekte dhe 90 ngastra. Subjektet po trajtohen sipas deklaratave noteriale të kufitareve sipas pikes 15 shkronja c të VKM-se 1182/2020. Janë përpiluar plan rilevimet sipas formatit të miratuar për 91 ngastra.

Me shkresë nr. 515 prot date 07.02.2025 është përpiluar njoftimi publik dhe materiali i perpunuar është afishuar në ambjentin e përcaktuar nga Njësia Administrative Gostil (Kopshti Gostil).

Lista e përdoruesve dhe paraqitja grafike e parcelave që kërkohet të kalohen në pronësi u afishua për 30 (tridhjetë) ditë kalendarike në fshatin Gostil adresa (Kopshti Gostil) dhe pranë Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kukës.

Nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kukës është bërë procesi i afishimit publik dhe mbajtja e ankesave, vërejtjeve të qytetareve si dhe është siguruar që të mbahen shenim në fletorën e vërejtjeve.

Me datë 11.03.2025 ka përfunduar afati afishimit publik të listës së përdoruesve dhe me 17.03.2025 është mbajtur procesverbali i përfundimit të afishimit publik. Sipas konfirmimit të Administratorit të njësive administrative gjatë periudhës së afishimit publik nuk është paraqitur asnjë vërejtje apo ankesë nga qytetarët.

Pas procesit të afishimit publik janë përpiluar planet e rilevit për tu firmosur nga subjektet kerkuese por gjatë kësaj faze 2 subjekte nuk kanë dorëzuar plan rilevimet e firmosura dhe në këto kushte nga 35 subjekte nëpërmjet kësaj shkrese do ju dërgohet lista me 33 subjekte. Po ashtu plan rilevimet në ato raste që janë evidentuar se bie rruga e Aeroportit janë ngare në dy ose me shumë parcela duke krijuar në total 91 plan rilevimi.

Drejtoria Vendore e ASHK-së Kukës në bashkëpunim me përfaqësuesit e Bashkisë Kukës ka përpiluar 91 plan rilevimi për 33 subjekte të cilat janë nënshkruar nga përfaqësuesit, subjektet dhe kufitarët. Të gjitha subjektet në lidhje me parcelat e afishuara kanë paraqitur marreveshje noteriale me kufitarët.

Për të gjithë subjektet janë përpiluar relacionet të cilat i keni të bashkëngjitura me materialet e dërguara me anë të kësaj përmbledhje.

Bashkëngjitur këtij relacioni keni:

1. Listen e përdoruesve faktik; (33 subjekte)
2. 91 plan rilevimi për çdo parcelë të afishuar;
3. 33 relacione për çdo subjekt dhe parcelat perkatese të afishuara.

Këshilli bashkiak vendos sipas nenit 14, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Në rastet kur këshilli bashkiak, me vendim të

arsyetuar, vendos rrëzimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”, ASHK-ja korrigjon përmbajtjen e listës, sipas vërejtjeve të arsyetuara të këshillit bashkiak, të cilën ia riparaqet për miratim këshillit bashkiak. Pas miratimit të vendimit nga këshilli bashkiak, ASHK-ja vijon me miratimin e vendimeve individuale për kalimin e tokës bujqësore në pronësi, pa shpërblim, për përfituesit.

Ju faleminderit !

DREJTORI
Erta Cenaj